

URDHËR
Nr.1, datë 5.1.2012

**PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA, PËR PROGRAMET E
STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË
DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË,
VITI AKADEMIK 2011-2012**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pikës 2 të vendimit nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Rishpërndarjen e kuotave të parealizuara, për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2011-2012, të shkronjës “a” të pikës 1 të vendimit nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012”, të ndryshuar, mbështetur në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

2. Kuotat e parealizuara dhënë institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të vendimit të sipërcituar, të shpërndahen sipas programeve dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj